

BANKA E SHQIPËRISË

PËRCAKTUESIT E MARZHIT NETO TË INTERESAVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

IRINI KALLUCI*



PËRMBAJTJA

1.	<i>Hyrje</i>	6
2.	<i>Përcaktuesit e marzhit neto të interesave sipas rezultateve kontabël, teorike dhe empirike</i>	8
2.1	<i>Analiza kontabël e marzhit neto të interesave</i>	9
2.2	<i>Analiza teorike e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të interesave</i>	10
2.3	<i>Rezultate të marra nga studime empirike rreth përcaktuesve të marzhit neto të interesave</i>	12
3.	<i>Analizë e marzhit neto të interesave për sistemin bankar shqiptar</i>	17
3.1	<i>Analiza e zbërthimit kontabël të marzhit neto të interesave për sistemin bankar shqiptar</i>	18
4.	<i>Rezultatet ekonometrike të marra nga analiza e marzhit neto të interesave për sistemin bankar shqiptar</i>	19
4.1	<i>Specifikimi i modelit</i>	20
4.2	<i>Të dhënat dhe metoda e vlerësimit</i>	24
4.3	<i>Rezultatet</i>	25
5.	<i>Përfundime</i>	30
	<i>Literatura</i>	32
	<i>Shtojcë</i>	35
	<i>Shënime</i>	37

ABSTRAKT

Studimi i eficiencës së sistemit bankar ka qenë përherë një çështje e diskutuar dhe me interes. Ky material trajton marzhin neto të interesave si një matës i eficiencës së bankave që operojnë në sistemin bankar shqiptar dhe fokusi kryesor është në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në masën e këtij treguesi. Sipas vlerësimeve të bëra për sistemin bankar shqiptar, rezulton se marzhi neto i interesave ndikohet nga luhatshmëria e normave të interesit (kryesisht për monedhën euro, atë vendase dhe lehtësisht dollarin), nga niveli i shpenzimeve të veprimtarisë që përgjithësisht ka qenë në rritje si dhe nga masa e rezervave të detyruara që bankat mbajnë pranë bankës qendrore. Të tjerë faktorë që ndikojnë marzhin neto janë niveli i kapitalizimit të bankave, që sidoqoftë duhet interpretuar me kujdes; të ardhurat neto nga komisionet të cilat janë të lidhura negativisht me variablin e varur çka nënkupton se këta dy tregues janë zëvendësues të njëri-tjetrit; efektiviteti i punës së administrimit; rreziku i kredisë dhe niveli i përqendrimit në terma të kredive.

Fjalë kyçe: Marzhi neto i interesave, sistem bankar.

1. HYRJE

Ndryshimet e rëndësishme politiko-ekonomike të ndodhura në Shqipëri që nga fillimi i viteve 1990, kanë ndikuar edhe zhvillimin dhe reformimin e sistemit bankar. Ky i fundit ka përjetuar kalimin nga një sistem monobankar drejt atij me dy nivele, procesin e privatizimit të bankave shtetërore, liberalizimin e normave të interesit dhe kredidhënies, prezantimin e instrumenteve indirekte të politikës monetare, forcimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës, hapjen ndaj hyrjes së institucioneve financiare të huaja dhe së fundmi, edhe shkrirjet e bashkimit e bankave. Të gjitha këto ndryshime kanë ndikuar në cilësinë e produkteve dhe shërbimeve që ofrojnë, në eficiencën e funksionimit të bankave, në nivelin e konkurrencës me të cilën ato ndeshen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përditshme dhe në kostot e ndërmjetësimit ndër vite.

Sistemi bankar është elementi më i rëndësishëm i sistemit financiar shqiptar, aktivet e të cilit zënë rreth 97 për qind të aktiveve të të gjithë sistemit financiar. Për rastin e Shqipërisë, bankat funksionojnë si aktorët kryesorë në kanalizimin e fondeve nga huadhënësit të huamarrësit, prandaj është e rëndësishme që roli ndërmjetësues i tyre të sigurojë një mirëqenie më të lartë për shoqërinë, mundësisht me kosto sa më të ulëta. Në këtë kontekst mori fillësën edhe ky studim, duke synuar të identifikojë faktorët që ndikojnë marzhin neto të interesave (NIM) për sistemin bankar shqiptar dhe duke shpresuar që do të kontribuojë në literaturën e shkruar rreth kësaj çështjeje, meqenëse një studim i tillë realizohet për herë të parë për rastin e Shqipërisë.

Marzhi neto i interesave shërben si matës i eficiencës së bankës dhe mund të llogaritet si raport i të ardhurave neto nga interesat me totalin e aktiveve apo me aktivet që sjellin të ardhura. Megjithatë, duhet marrë parasysh se një reduktim i këtij treguesi jo në të gjitha rastet sinjalizon përmirësim efieencie. Një reduktim i marzhit neto të interesave mund të shkaktohet nga një rënie në normën e tatimit apo rritje në normën e moskthimit të kredive (nëse do merret parasysh zberthimi kontabël i këtij treguesi). Në rastin e parë, reduktimi i marzhit neto të interesave mund të reflektojë përmirësim të funksionimit të sistemit bankar, kurse në rastin e dytë

duhet pohuar e kundërta (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga 1999). Nga ana tjetër, nëse do të merret parasysh vetë formula e llogaritjes së marzhit neto të interesave, ndryshimi i tij mund të shkaktohet si nga luhatjet në numërues (të ardhura neto nga interesat) ashtu edhe në emërues (për shembull, aktivet që sjellin të ardhura). Në këto kushte, studimi i faktorëve që mund të shkaktojnë këto ndryshime në kostot e ndërmjetësimit, përbën një fushë interesante dhe gjerësisht të trajtuar nga literatura e huaj.

Grupe të ndryshme interesi, por sidomos politikëbërësit janë të interesuar në ngritjen dhe funksionimin e sistemeve bankare që gëzojnë stabilitet dhe eficiencë. Stabiliteti kërkon kthime të mjaftueshme, ndërsa efienca ekonomike kërkon marzhe jo shumë të larta të aplikuara nga bankat. Rezultatet e marra nga analiza e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të interesave, mund të jenë të dobishme për hartimin e masave specifike të politikave ekonomike. Nëse për shembull, një pjesë e mirë e ecurisë së marzhit neto të interesave shpjegohet nga luhatshmëria e normave të interesit, politikat duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të mund të krijojnë një mjedis makroekonomik stabil dhe me norma më pak të luhatshme. Nëse nga ana tjetër, marzhi neto ndikohet më shumë nga pozicioni i bankave në treg, kjo do të thotë se politikat duhet të orientohen drejt inkurajimit të rritjes së konkurrencës midis bankave. Në varësi të kontributit që çdo variabël (rreziku i kredisë, shpenzimet operative, cilësia e administrimit etj.) jep në shpjegimin e marzhit të interesave, mund të orientohen edhe politikat e ndjekura ndaj aspekteve të veçanta të aktivitetit bankar.

Modeli bazë i përdorur në literaturë për identifikimin e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të interesave, është ai i ndërmjetësimit¹, i përdorur për herë të parë nga Ho dhe Saunders (1981), sipas të cilit bankat shihen si ndërmjetës financiarë kundërshtarë të rrezikut. Më pas, autorë të tjerë kanë punuar mbi këtë model, duke paraqitur në studimet e tyre edhe përmirësime e përshtatje me gjendjen specifike të ekonomive ku është aplikuar.

Studimi do të jetë i strukturuar si vijon: në seksionin e dytë do të përshkruhet metodologjia e përdorur për identifikimin e përcaktuesve të marzhit neto të interesave sipas modelit kontabël,

modelit teorik si edhe rezultatet empirike të marra nga studime të ndryshme. Në seksionin e tretë kalohet në një pamje të përgjithshme të ecurisë së marzhit neto të interesave për sistemin bankar shqiptar. Në seksionin e katërt analizohen nga pikëpamja empirike faktorët përcaktues të marzhit neto të interesave të bankave që operojnë në sistemin bankar shqiptar. Seksioni i pestë paraqet konkluzionet e studimit.

2. PËRCAKTUESIT E MARZHIT NETO TË INTERESAVE SIPAS REZULTATEVE KONTABËL, TEORIKE DHE EMPIRIKE

Bernanke (1983) e ka përcaktuar koston e ndërmjetësimit si diferencë midis kostove bruto të paguara nga huamarrësi dhe kthimeve neto të marra nga kursimtarët. Megjithëse nuk ka një përkufizim të vetëm të marzhit të interesave në literaturën empirike, ai që mbizotëron është Marzhi Neto i Interesave (raporti i të ardhurave neto nga interesat me aktivet që sjellin të ardhura). Shpesh herë ky tregues llogaritet edhe në raport me totalin e aktiveve dhe ndryshimet nuk janë shumë domethënëse nëse aktivet që sjellin të ardhura përbëjnë një pjesë të rëndësishme të aktiveve totale.

Ekzistojnë dy mënyra të matjes së marzhit neto të interesave: ex-ante dhe ex-post. Sipas mënyrës së parë, marzhi neto i interesave llogaritet si diferencë e normave të interesit të kredive dhe depozitave që bankat specifikojnë në kontratë që në fillim. Këto janë normat që publiku shikon dhe që janë lehtësisht të krahasueshme midis tyre. Sipas mënyrës së dytë, treguesi llogaritet si diferencë e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit që banka ka realizuar gjatë periudhës, sipas të dhënave të marra nga pasqyrat financiare (pasi janë realizuar). Diferenca midis dy marzheve lidhet me nivelin e kredive me probleme. Metoda më e përdorur është ajo ex-post pasi rezultatet e dhëna janë më të sakta. Shpesh vihet re se të dhënat e grumbulluara nga analiza ex-ante mund të jenë jokonsistente, për arsyen se merren nga burime të ndryshme. Por nga ana tjetër, edhe mënyra ex-post ka mangësitë e veta, pasi të ardhurat nga interesat

dhe rezervat e krijuara për një kredi me probleme, materializohen në momente të ndryshme kohore (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga 1998).

Nga një analizë ex-ante e diferencave midis normave mesatare të interesit të kredive dhe depozitave të reja, shihet se Shqipëria është ndër vendet e rajonit, me nivel më të lartë të këtij treguesi (shiko tabelën nr. 2 në shtojcën e studimit). Kjo formë e matjes, jep rezultate dukshëm të ndryshme nga marzhi neto i interesave që do të përdoret përgjatë gjithë studimit dhe që do të llogaritet si një tregues ex-post, bazuar në të dhëna të pasqyrave financiare të bankave.

Për identifikimin dhe analizën e faktorëve që përcaktojnë marzhin neto të interesave në sistemin bankar, përdoren dy metoda. E para, është metoda e zbrërthimit kontabël të marzhit neto të interesave (që do të trajtohet në vijim) dhe e dyta, ka të bëjë me një trajtim teorik të faktorëve ndikues që më pas aplikohen edhe në praktikë nëpërmjet analizave ekonometrike.

2.1 ANALIZA KONTABËL E MARZHIT NETO TË INTERESAVE

Ekzistojnë forma të ndryshme të të analizuarit të marzhit të interesave, njëra prej të cilave është analiza kontabël, realizuar për herë të parë nga Hanson dhe Rocha (1986). Nisur nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve (duke marrë parasysh edhe modelin e pasqyrave financiare të bankave tregtare që operojnë në Shqipëri), rezulton ekuacioni i mëposhtëm:

$$NI = NII - (OE - NNII - NEI) - LLP - T \quad (1)$$

ku, *NI* (Net Income) përfaqëson rezultatin neto të bankave (pas tatimit), *NII* (Net Interest Income) është rezultati neto nga interesat, *OE* (Operating Expenses) i korrespondon shpenzimeve të

veprimtarisë, *NNII* (Net Non-Interest Income) qëndron për rezultatin neto nga veprimtari të tjera, *NEI* (Net Extraordinary Income) është rezultati neto i jashtëzakonshëm, *LLP* (Loan Loss Provisions) tregon shpenzimet për provigjone dhe *T* (Taxes) qëndron për taksat dhe tatimet.

Nëse do të bëjmë një rishpërndarje të zërave të ekuacionit (1) dhe t'i shprehim si përqindje ndaj totalit të aktiveve (*TA*), mund të vërehen zërat që ndikojnë më shumë në përcaktimin e marzhit neto të interesave (*NIM*), i cili llogaritet si raport i rezultatit neto nga interesat me totalin e aktiveve.

$$NIM = \frac{(OE - NNII - NEI)}{TA} + \frac{LLP}{TA} + \frac{T}{TA} + \frac{NI}{TA} \quad (2)$$

Nga ekuacioni (2) dallohet qartë se sipas analizës kontabël, marzhi neto i interesave ndikohet nga masa e shpenzimeve të veprimtarisë që nuk mbulohen nga të ardhura të tjera (jo nga interesat), niveli i shpenzimeve për provigjone që bankat parashikojnë për portofolin e kredive, shuma e taksave dhe tatimeve që i paguajnë organeve tatimore dhe niveli i fitimit që ato sigurojnë nga operimi në treg.

2.2 ANALIZA TEORIKE E FAKTORËVE QË NDIKOJNË MARZHIN NETO TË INTERESAVE

Një tjetër trajtim i faktorëve përcaktues të marzhit të interesave është ai teorik. Për herë të parë një trajtim i tillë është realizuar nga Ho dhe Saunders (1981) dhe është quajtur modeli i ndërmjetësismit. Mënyra sesi ky model funksionon, shkurtimisht mund të shpjegohet si vijon: bankat konsiderohen si agjentë kundërshtues të rrezikut që grumbullojnë depozita dhe japin kredi, të cilat mbërrijnë në mënyrë të rastësishme dhe ku probabiliteti i mbërritjes varet nga marzhet që bankat vendosin dhe nga elasticiteti i kërkesës për kredi/ofertës së depozitave. Natyra rastësore e kërkesës për kredi dhe ofertës së depozitave i ekspozon ato ndaj rrezikut të normës së interesit. Supozojmë se një depozitë pranohet nga një bankë dhe për shkak të

mungesës së kërkesës së njëkohshme për kredi, ajo do të investohet në tregun e parasë. Në një rast të tillë banka ndeshet me rrezikun e riinvestimit në fund të periudhës së maturimit të investimit, kur asaj do t'i duhet ta riinvestojë këtë shumë. Nga ana tjetër, nëse një kërkesë për kredi financohet në tregun e parasë, banka do të ndeshë rrezikun e refinancimit pasi në fund të periudhës së maturimit të burimit të financimit, do t'i duhet të rigjejë përsëri fonde. Në këtë rast, përveç rrezikut të interesit, banka mund të ndeshë edhe rrezikun e moskthimit të kredisë. Kështu, një ndërmjetës financiar kundërshtues rreziku, do të kërkojë në këmbim një marzh më të lartë.

Ho dhe Saunders (1981) kanë argumentuar në studimin e tyre se shtesa (mark up-i) që bankat do të caktojnë mbi normat e interesit të tregut si për depozitat ashtu edhe për kreditë, teorikisht do të varet nga katër faktorë: (I) qëndrimi i bankave ndaj rrezikut; (II) struktura e tregut ku bankat operojnë; (III) madhësia mesatare e transaksioneve që bankat realizojnë; dhe (IV) luhatshmëria e normave të interesit. Sipas këtyre autorëve, edhe nëse bankat operojnë në një treg me konkurrencë të lartë, marzhet do të vazhdojnë të jenë pozitive. Kjo do të thotë se marzhet e normës së interesit nuk do të zhduken, pasi pasiguria i shoqëron gjithmonë transaksionet e kryera. Ky lloj marzhi i shkaktuar nga pasiguria që shoqëron transaksionet, quhet marzh "i pastër". Modeli i mësipërm zbatohet në dy faza. Së pari duke realizuar përcaktimin e madhësisë së marzhit "të pastër", nëpërmjet paraqitjes së efektit të variablave shpjegues që nuk janë shprehur në mënyrë eksplicite në modelin teorik dhe më pas, duke analizuar marrëdhënien midis marzhit të "pastër" dhe variablave të paraqitur në modelin teorik.

Sipas modelit të Ho dhe Saunders (1981), bankat shihen si ndërmjetës që pranojnë depozita dhe japin kredi në mënyrë pasive. Kjo do të thotë se çmimet e kredive dhe depozitave (P_L dhe P_D) vendosen nga banka ndërsa sasia e tyre përcaktohet në mënyrë ekzogjene. Kështu,

$$P_L = p - b \text{ dhe } P_D = p + a,$$

ku p - është opinionimi i bankës për çmimin "e vërtetë" të kredisë

apo depozitës, ndërsa a dhe b - janë marzhe sigurie për shpejtësinë e shërbimit. Meqënëse P_L dhe P_D janë çmime, ato lidhen në mënyrë të zhdrejtë me normat e interesit të kredive dhe depozitave. Kështu, ndryshe mund të thuhet se $r_D = r - a$ dhe $r_L = r + b$ ku r_D dhe r_L - janë normat e interesit të depozitave dhe kredive që banka cakton, ndërsa r - është norma e interesit në tregun e parasë.

Në këtë mënyrë, mund të thuhet se marzhi i interesave (s) llogaritet: $s = r_L - r_D = a + b$

Sipas Ho dhe Saunders (1981)¹, pas një sërë transformimesh të këtij ekuacioni bazë, rezulton se

$$s = r_L - r_D = \alpha/\beta + 1/2 * R\sigma_1^2 Q$$

ku, α/β tregon *spread-in* neutral të rrezikut ose vetë α dhe β shprehin përkatësisht ndërprerjen me boshtin vertikal dhe pjerrësinë e funksionit simetrik të mbërritjes së depozitave dhe kredive. Si rrjedhojë, ky raport mat në njëfarë mënyre shkallën e fuqisë monopolistike. Pjesa tjetër e formulës përfshin elemente të një primi rreziku. R qëndron për koeficientin e sjelljes ndaj rrezikut, σ_1^2 për variancën e luhatjes së normave të interesit dhe Q për madhësinë e transaksioneve të kryera.

2.3 REZULTATE TË MARRA NGA STUDIME EMPIRIKE RRETH PËRCAKTUESVE TË MARZHIT NETO TË INTERESAVE

Shumë studime empirike janë realizuar për identifikimin e faktorëve përcaktues të marzhit neto të interesave, si për grup vendesh, ashtu edhe për ekonomi të veçanta; si për banka individuale ashtu edhe për të dhëna të agreguara në nivel sistemi.

Modeli i ndërmjetësimit (dyfazësh) i përdorur nga Ho dhe Saunders (1981) dhe më pas nga Saunders dhe Schumacher (2000) është përdorur nga autorë të ndryshëm për të analizuar ndikimin

e faktorëve shpjegues të marzhit neto të interesave. Megjithëse aplikimi i këtij modeli ka avantazhin e vlerësimit të një marzhi “të pastër”, përdorimi i tij kërkon seri të gjata kohore për variablat që përcaktojnë marzhin “e pastër”. Nga ana tjetër, McShane dhe Sharpe (1985), Angbazo (1997) dhe Maudos e Fernández de Guevara (2004) e kanë aplikuar modelin në një fazë të vetme, duke përfshirë në variablat shpjegues të marzhit neto të interesit jo vetëm ata të përmendur në modelin teorik, por edhe variabla e papërsosmëri të papërfshira në modelimin e marzhit të pastër.

Demirgüç-Kunt dhe Huizinga (1999) në studimin e tyre kanë analizuar një grup prej 80 vendesh dhe kanë parë se marzhi neto i interesave rezulton më i lartë për vendet në tranzicion sesa për ato të industrializuara. Gjithashtu, është dalë në konkluzionin se bankat e huaja kanë prirjen që të caktojnë marzhe më të larta interesi në vendet në zhvillim sesa në vendet e zhvilluara (Claessens, Demirgüç-Kunt dhe Huizinga 1997). Arsyeja e kësaj sjelljeje mund të lidhet me faktin se bankat e huaja kanë avantazhe teknologjike krahasuar me bankat vendase (në vendet në zhvillim), por nga ana tjetër zotërojnë disavantazhin e mungesës së informacionit të plotë për tregun vendas. Për më tepër, këto banka mund të jenë edhe subjekt i pagesës së taksave apo edhe i provigjonimeve në nivele më të ulëta.

Nga studimet e kryera janë marrë rezultate të ndryshme (në disa raste edhe kontradiktore) përsa i përket lidhjes së marzhit neto të interesave me faktorë të ndryshëm që e ndikojnë atë. Më poshtë renditen disa nga faktorët përcaktues të marzhit të interesave që kanë rezultuar nga analizat ekonometrike:

Niveli i kapitalizimit – Demirgüç-Kunt dhe Huizinga (1998), Saunders dhe Schumacher (2000), Afanasieff et al. (2002), Liebeg dhe Schwaiger (2006), kanë gjetur lidhje pozitive midis marzhit neto të interesave dhe kapitalizimit të bankave. Brock dhe Franken (2002) kanë gjetur lidhje negative midis këtyre dy treguesve, duke dhënë si shpjegim se bankat e mirëkapitalizuara janë më konservatore në drejtim të dhënies së kredive (duke rezultuar në marzhe më të ulëta) pasi kapitali aksioner është më i rrezikuar. Ndërsa bankat më pak të kapitalizuara janë më të nxitura për të

marrë më shumë rrezik (duke rezultuar në marzhe më të larta) për të siguruar më shumë fitime.

Shpenzimet operative – Në studimin e tyre, Ho dhe Saunders nuk kanë përfshirë kostot operative si një nga faktorët përcaktues të marzhit të interesave. Lerner (1981) e ka kritikuar këtë fakt, duke argumentuar se bankat kanë edhe shpenzime të tjera operative gjatë ushtrimit të funksionit të tyre si ndërmjetës financiarë. Për këtë arsye, Maudos dhe Fernández de Guevara (2004) e kanë përfshirë në modelin e tyre të përmirësuar, këtë faktor përcaktues. Kuptohet që sa më të larta të jenë kostot operative, aq më të larta do të jenë edhe marzhet që bankat caktojnë për të mbuluar këto kosto. Liebeg dhe Schwaiger (2006), Estrada et.al (2006), Naceur (2003), Affanasief et al.(2002), Maudos dhe Fernández de Guevara (2004) kanë gjetur lidhje pozitive midis marzhit të interesave dhe shpenzimeve operative.

Koeficienti përpara këtij variabli tregon se ç'pjesë e kostove operative të bankës kalon te depozituesit dhe huamarrësit (në terma të normave më të ulëta të interesit për depozitat dhe/ose normave më të larta për kreditë). Edhe në mungesë të fuqisë në treg dhe të çdo lloj rreziku, bankat caktojnë marzhe pozitive për të mbuluar pikërisht kostot e veprimtarisë.

Madhësia e bankave – Naceur (2003) shprehet se bankat e mëdha prirën të ulin marzhet si rezultat i ekonomive të shkallës.

Pjesa e tregut të depozitave apo kredive – ku studime të ndryshme kanë marrë rezultate të ndryshme. Nëse lidhja rezulton pozitive, do të thotë se një bankë që ka një pjesë të lartë të tregut të depozitave, ka më shumë fuqi dhe si e tillë ajo mund të vendosë marzhe më të larta. Një shenjë negative e koeficientit tregon për eficiencë në përdorimin e ekonomive të shkallës, duke transferuar disa nga përfitimet te klientët, në formën e marzheve më të ulëta.

Rreziku i kredisë – kreditë me probleme janë një matës i rrezikut të kredisë. Në këtë mënyrë, sa më i lartë niveli i tyre, aq më i lartë rreziku i kredisë e rrjedhimisht më i lartë do të jetë edhe marzhi i interesave pasi banka kërkon të mbulojë humbjet nga këto lloj kredish duke i kaluar kostot shtesë te klientët, nëpërmjet normave

më të larta të interesit për kreditë ose më të ulëta për depozitat, apo një kombinim të të dyjave. Maudos dhe Fernández de Guevara (2004), Brock dhe Franken (2002) e Demirgüç-Kunt dhe Huizinga (1998) kanë gjetur një lidhje pozitive të marzhit të interesave me rrezikun e kredisë.

Nga studime të realizuara për disa vende të Amerikës Latine ka rezultuar një lidhje negative midis dy variablave (Brock dhe Rojas-Suárez 2000). Kjo mund të shpjegohet me rënien e normës së interesit për kreditë ose me rritjen e normës së interesit të depozitave. Rënia e normës së interesit të kredive mund të ndiqet nga bankat që, pavarësisht nivelit të lartë të kredive me probleme, rrezikojnë të ulin të ardhurat duke synuar rritjen e pjesës së tregut. Nga ana tjetër, në studimet e bëra për vendet e Amerikës Latine shprehet se norma e interesit të depozitave rritet si kundërpërgjigje ndaj rritjes së normës së kredive me probleme, në nivel sistemi. Këto rezultate mund të kenë dy shpjegime: së pari, rritja e nivelit të kredive me probleme mund të rrezikojë mundësitë e qeverisë për të ofruar garanci te depozituesit, çka do të shoqërohet me reagimin e bankave për të rritur normat e interesit të depozitave që t'i bëjnë më tërheqëse. Së dyti, për sistemet bankare jo të konsoliduara, bankat e kapitalizuara në mënyrë të pamjaftueshme, do të gjejnë një mënyrë për rritur burimet e financimit nëpërmjet rritjes së normave të depozitave. Në nivel bankash individuale, efekti i rritjes së normave të interesit si kundërpërgjigje ndaj rritjes së kredive me probleme, nuk do të jetë aq i madh sa në nivel sistemi, pasi depozituesit shqetësohen më tepër për sigurimin e depozitave sesa për problemet e një banke të veçantë. Nëse sistemi i sigurimit të depozitave funksionon si duhet, bankat ndeshen me një ofertë elastike të depozitave, kështu që mjafton një rritje e vogël e normës së interesit për të siguruar fonde për mbulimin e humbjeve nga kreditë.

Të ardhurat jo nga interesat – zakonisht kanë një ndikim negativ mbi marzhin e interesave³. Bankat janë të gatshme të ulin marzhet e tyre nëse do të sigurojnë një rritje kompensuese në të ardhurat nga komisionet dhe jo nga interesat. Megjithatë, në literaturë paraqiten dy lloj lidhjesh midis këtyre faktorëve. Në një treg bankar me konkurrencë të lartë, ku bankat nuk mund të ndikojnë plotësisht, të ardhurat nga komisionet pritet të funksionojnë si zëvendësuese

të të ardhurave nga interesi. Në këtë rast, lidhja midis marzhit neto të interesave dhe të ardhurave neto nga komisionet do të rezultojë negative. Nëse bankat gëzojnë një lloj fuqie në tregun ndërbankar (si pasojë e specializimit në produkte dhe shërbime të veçanta), ato mund të ndikojnë në caktimin e normës së interesit duke bërë që në këtë rast të ardhurat nga komisionet dhe nga interesat të rezultojnë si plotësuese të njëra-tjetrës dhe lidhja të rezultojë pozitive (Estrada et al. 2006).

Cilësia e administrimit - Angbanzo (1997) dhe Maudos e Fernández de Guevara (2004) shprehen se një administrim cilësor nënkupton përzgjedhjen e aktiveve me cilësi të mirë (me rrezik të ulët e kthim të lartë) dhe pasiveve me kosto të ulët. Meqënëse cilësia e administrimit matet nga raporti kosto/të ardhura, një rritje e këtij raporti do të thotë një përkeqësim i cilësisë së administrimit dhe si pasojë, edhe rënie në marzhin neto të interesave.

Kostot oportune – Siç dihet, bankat janë të detyruara të depozitojnë pranë bankës qendrore, rezervën e detyruar⁴. Kostoja oportune e mbajtjes së rezervës, duhet të kompensohet nga caktimi i normave më të larta të interesit për kreditë. Në studimin e tyre, Estrada et al. (2006) dhe Gelos (2006), kanë gjetur një vlerë pozitive të koeficientit para këtij variabli.


Rritja e PBB-së - Bernanke dhe Gertler (1989) kanë arritur në konkluzionin se aftësia paguese e huamarrësve është kundërciklike. Koeficienti duhet të ketë një shenjë negative, pasi gjatë periudhave të rënies ekonomike, aftësia paguese bie dhe në këtë mënyrë, huamarrësit mund të marrin hua vetëm me norma më të larta interesi, duke rritur kështu marzhin e interesave.

Duke patur parasysh rezultatet e marra nga të gjithë autorët e sipërpërmendur për lidhjen e këtyre faktorëve me marzhin neto të interesave, duket e arsyeshme që disa prej këtyre variablave të përfshihen edhe në ekuacionet që do të vlerësohen për rastin e sistemit bankar shqiptar. Nga ana tjetër, duke konsideruar kushtet financiare apo makroekonomike të Shqipërisë si dhe disa karakteristika të veçanta në sjelljen e bankave shqiptare, do të shtohen edhe variabla të tjerë për t'i përshtatur me këto kushte.

3. ANALIZË E MARZHIT NETO TË INTERESAVE PËR SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

Sistemi bankar shqiptar është karakterizuar në përgjithësi nga norma të larta interesi për kreditë dhe nga një nivel i ulët kreditimi në raport me PBB-në⁵. Vitet e fundit, me hyrjen e bankave të huaja të fuqishme dhe me rritjen e konkurrencës në tregun bankar, është vënë re një rritje e nivelit të kreditimit të sektorit privat dhe një ulje e normave të interesit për kreditë.


Marzhi neto i interesave (në nivel sistemi) ka ardhur në rritje sidomos vitet e fundit, çka përkon edhe me periudhën kur sistemi bankar shqiptar ka filluar të shfaqë agresivitet në drejtim të kredidhënies dhe angazhimit në aktivitete me përfitueshmëri dhe rrezik më të lartë. Nga ana tjetër, bankat gjatë kësaj periudhe kanë shtuar numrin e degëve për të pasur një shtrirje më të madhe gjeografike⁶, gjë që është shoqëruar me rritjen e shpenzimeve të veprimtarisë. Këto të fundit janë ndikuar edhe nga rritja e numrit të punonjësve, i cili është mëse dyfishuar për periudhën 2003-2007⁷. Në grafikun nr. 1 paraqitet ecuria e marzhit neto të interesave (NIM_1 dhe NIM_2) të matur sipas të dyja mënyrave që përdoren në literaturë. Ecuria e tyre ka qenë e njëjtë përgjatë periudhës së marrë në shqyrtim. Diferenca jo shumë e madhe që ekziston midis tyre dëshmon se aktivet që sjellin të ardhura përbëjnë pjesën më të madhe të aktiveve të bankave.



3.1 ANALIZA E ZBËRTHIMIT KONTABËL TË MARZHIT NETO TË INTERESAVE PËR SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

Në vijim trajtohet zërthimi kontabël i marzhit neto të interesave për sistemin bankar shqiptar, sipas zërave të raportuar nga bankat tregtare në Bankën e Shqipërisë.

Grafik 2. Marzhi neto i interesave i zërthyer sipas analizës kontabël.



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autores.

Ashtu siç vërehet nga grafiku i mësipërm dhe nga një analizë e strukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve, rezulton se:

- Marzhi neto i interesave ka ardhur në rritje sidomos gjatë tre viteve të fundit, një dukuri kjo, e shoqëruar edhe me rritjen e shpejtë të kreditimit. Duhet përmendur se në fund të vitit 2001 kredia zinte vetëm 9 për qind të aktiveve të sistemit bankar, ndërsa në dhjetor 2007 kjo shifër arriti në rreth 40 për qind.
- Niveli i lartë i shpenzimeve të veprimtarisë që nuk mbulohen nga rezultati neto i jashtëzakonshëm dhe ai i siguruar nga aktivitete të tjera, ka rezultuar në nivele më të larta të marzhit neto të interesave duke zënë pjesën më të madhe të tij. Ky nivel i lartë është shkaktuar si nga rritja e shpenzimeve të veprimtarisë, ashtu edhe nga rënia e të ardhurave të siguruara nga veprimtari të tjera (jo nga interesat)⁸. Sistemi

bankar shqiptar shfaq një varësi të theksuar nga të ardhurat prej interesave, për shkak të përqendrimit të investimeve të këtij sektori kryesisht në kredi dhe letra me vlerë. Të ardhurat nga komisionet megjithëse në vlerë absolute janë rritur gjatë periudhës së marrë në studim, përsëri ato mbeten në nivele shumë të ulëta në raport me totalin e aktiveve (luhaten rreth vlerës 0.6 për qind të totalit të aktiveve).

- Vetë shpenzimet e veprimtarisë janë rritur midis të tjerash edhe si pasojë e rritjes së shpenzimeve të personelit (rritje e numrit të të punësuarve dhe e shpërblimeve ndaj tyre). Këto të fundit përbëjnë rreth 40 për qind të shpenzimeve operative të sistemit bankar shqiptar.
- Vitet e fundit si pasojë e rritjes së shpejtë të aktiveve me rrezik, është rritur edhe niveli i shpenzimeve të provigjoneve që ka ndikuar në rritjen e marzhit neto të interesave.
- Më tej, edhe rezultati neto në raport me totalin e aktiveve (ROA) që bankat kanë gjeneruar përbën një element të rëndësishëm të marzhit neto, duke dëshmuar për një përfitueshmëri të lartë të tyre.
- Niveli i taksave që bankat kanë paguar ka ardhur në rënie.

4. REZULTATET EKONOMETRIKE TË MARRA NGA ANALIZA E MARZHIT NETO TË INTERESAVE PËR SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

Sistemet bankare të ekonomive në proces liberalizimi dhe reformimi të sistemeve financiare, nuk janë në ekuilibër afatgjatë (Brock dhe Rojas-Suarez, 2000). Për këtë arsye, interpretimi i rezultateve të marra, duhet bërë me kujdes pasi ato nuk janë të drejtpërdrejta ashtu siç ndodh për ekonomitë e zhvilluara. Sistemet bankare jo të konsoliduara janë të prirura për të ndërmarrë më shumë rrezik. Në këto sisteme, përgjigjja e normave të interesit të kredive dhe depozitave si dhe e marzhit të interesave, mund të jetë e ndryshme nga ajo që pritet dhe nga sa është provuar për sistemet e zhvilluara. Meqënëse për periudhën e marrë në studim edhe sistemi bankar shqiptar, nuk ka arritur në një konsolidim të

plotë të tij, interpretimi i rezultateve të marra do të bëhet me kujdes dhe duke u krahasuar edhe me vende të tjera të të njëjtit nivel zhvillimi.

Në këtë seksion do të analizohen me metoda ekonometrike faktorët që mendohet se kanë ndikim në marzhin neto të interesave për bankat e sistemit bankar shqiptar.

4.1 SPECIFIKIMI I MODELIT

Modeli i ndërmjetësimit i Ho dhe Saunders (1981)⁹ vlerëson faktorët përcaktues të marzhit neto të interesave duke ndjekur dy faza, por kërkon seri të gjata kohore. Më pas, autorë të tjerë (McShane dhe Sharpe 1985, Angbazo 1997 dhe Maudos e Fernández de Guevara 2004) kanë aplikuar modelin njëfazësh për përcaktimin e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të interesave. Meqënëse në rastin e Shqipërisë të dhënat i përkasin një serie të shkurtër (2002-2007), është e pamundur të aplikohet modeli i parë. Në këtë mënyrë, vlerësimi do të bëhet me modelin njëfazësh të aplikuar nga Maudos e Fernández de Guevara (2004), të cilët kanë identifikuar faktorët që ndikojnë marzhin neto të interesave për 5 vende të Bashkimit Evropian, të analizuara me metodën Panel Data për banka individuale. Në dallim nga këta autorë, në studimin tim kam identifikuar faktorët përcaktues të marzhit neto të interesave për rastin e një vendi të vetëm, Shqipërisë.

Maudos e Fernández de Guevara (2004) kanë gjetur në përgjithësi lidhje statistikisht të rëndësishme dhe me shenjën e parashikuar nga modeli teorik, të marzhit të interesave me të gjithë variablat e pavarur të përfshirë në studim. Variabli i varur (marzhi neto i interesave) në studimin tim është llogaritur në dy forma; një herë si raport i të ardhurave neto nga interesat me totalin e aktiveve dhe një herë, si raport i të ardhurave neto nga interesat me aktivet që sjellin të ardhura, në ndryshim nga studimi origjinal ku është llogaritur vetëm në formën e parë¹⁰. Një tjetër dallim lidhet edhe me variablat e përfshirë në studim. Numri i tyre për rastin e Shqipërisë është më i vogël sesa në studimin të cilit i jam referuar, pasi numri i vogël i observimeve nuk më lejon të përdor

një numër të madh variablash. Kështu, në dallim nga studimi të cilit i jam referuar nuk kam përfshirë në ekuacion variablin që shpreh shkallën e ndërveprimit midis rrezikut të kredisë dhe të tregut, meqenëse këto rreziqe janë përfshirë edhe në mënyrë të veçantë në studim; dhe variablin që shpreh madhësinë mesatare të transaksioneve të matur nga vëllimi i kredive të dhëna. Maudos e Fernández de Guevara (2004) e kanë matur fuqinë e bankave në treg një herë duke përdorur indeksin LERNER dhe herën tjetër atë të Herfindahl-Hirschman, ndërsa në rastin e Shqipërisë është përdorur vetëm ky i fundit si pasojë e mungesës së të dhënave të nevojshme për llogaritjen e indeksit të parë. Rrezikun e tregut, autorët e mësipërm e kanë matur me luhatshmërinë e normave të interesit të tregut ndërbankar apo borxhit publik, në dallim nga rasti i Shqipërisë ku si përafrues i këtij rreziku është marrë devijimi standard i normave të interesit të bonove të thesarit, euribor dhe libor. Për sistemin bankar shqiptar është vepruar në këtë mënyrë, pasi dihet se si kreditë, ashtu edhe depozitat janë të shprehura kryesisht në lekë, euro dhe dollarë.

Zërat e bilancit të përfshirë në llogaritjen e variablove, janë llogaritur si vlera mesatare të fillimit dhe fundit të tremujorit të marrë në shqyrtim, për të zbutur luhatjet nga njëri fund tremujori në tjetrin. Ndërkohë që për zërat e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve që janë përdorur në llogaritje, është marrë vetëm vlera e shtuar gjatë tremujorit në fjalë.

Në modelin tim, do të përdoren 8 variabla shpjegues që mendohet se ndikojnë marzhin neto të interesave, nisur nga modeli teorik apo edhe studime empirike të të njëjtës natyrë. Kështu, variablat e pavarur të përfshirë në studim janë:

A) SHPENZIMET OPERATIVE

Variabli që do të përdoret për shpenzimet operative, llogaritet si raport i shpenzimeve të veprimtarisë me totalin e aktiveve dhe pritët të ketë ndikim pozitiv mbi marzhin neto të interesave. Shpenzimet e veprimtarisë do të përfshihen në ekuacion për të provuar nëse kostot më të larta kalohen apo jo te klientët e bankës, në trajtën e caktimit të marzheve më të larta.

B) QËNDRIMI NDAJ RREZIKUT

Si një përafres i mirë i qëndrimit që bankat shfaqin ndaj rrezikut, shërben raporti i kapitalit të vet me totalin e aktiveve. Normalisht pritet një lidhje pozitive me variablin e varur, pasi bankat që janë më rrezikkundërshtuese, do të prirën të caktojnë marzhe më të larta si kundërpërgjigje. Megjithatë, një nivel më i lartë kapitalizimi i bankave duhet të interpretohet me kujdes, pasi jo domosdoshmërisht mund të shkaktohet si pasojë e qëndrimit të bankave ndaj rrezikut. Shpeshherë bankat janë të detyruara të mbajnë një nivel të caktuar kapitali si pasojë e kërkesave rregullative dhe mbikëqyrëse¹¹ dhe jo pse ato mund të jenë rrezikkundërshtuese.

C) RREZIKU I KREDISË

Ky tregues është llogaritur si raport i kredive me probleme ndaj totalit të kredive dhe është menduar të vendoset në ekuacion me kohë vonesë, sepse është normale që bankat të reagojnë pas njëfarë kohe ndaj nivelit të kredive me probleme. Pritet një koeficient pozitiv para këtij variabli, pasi për një nivel më të lartë rreziku, bankat do të caktojnë më shumë prim rreziku mbi normat e interesit të kredive të reja. Pra në njëfarë mënyre, do të jenë kredimarrësit e rinj ata që do të paguajnë kostot e moskthimit të kredive të vjetra.

D) CILËSIA E ADMINISTRIMIT

Cilësia e administrimit zakonisht përafrohet nga raportet kosto/ të ardhura. Një administrim cilësor do të thotë gjetje e aktiveve me rrezik të ulët dhe të ardhura të larta si dhe e pasiveve me kosto të ulët. Ky tregues për studimin në fjalë është përlllogaritur nga raporti i shpenzimeve të veprimtarisë me të ardhurat bruto të veprimtarisë, që nënkupton nivelin e shpenzimeve operative për të gjeneruar një njësi të ardhur. Nëse ky raport rritet, do të thotë se kemi rënie të cilësisë së administrimit që nga ana tjetër, do të shoqërohet me rënie të marzhit neto të interesave. Pra, do të pritet një lidhje negative.

E) KOSTOT OPORTUNE TË MBAJTJES SË REZERVAVE

Këto kosto përlllogariten në rastin tonë si raport i rezervës së detyruar në bankën qendrore me totalin e aktiveve¹². Pritet të

merret një lidhje pozitive me variablin e varur, pasi një nivel më i lartë i rezervës (të remuneruar me norma interesi më të ulëta¹³) do të ndikojë në caktimin e normave më të larta të interesit për kreditë (apo më të ulëta për depozitat) për të kompensuar fitimin e munguar nga investimi i fondeve në formën e rezervës së detyruar. Ky variabël do të përfshihet në ekuacion me kohëvonesë, duke menduar se efektet e mbajtjes së rezervave në bankën qendrore do të shfaqen në normat e interesit të kredive dhe depozitave, pas disa periudhash.

F) TË ARDHURAT JO NGA INTERESAT

Një tjetër variabël që do të përfshihet në ekuacion janë edhe të ardhurat neto nga komisionet (si përqindje ndaj totalit të të ardhurave neto nga interesat dhe të ardhurave neto nga veprimtari të tjera). Në pamje të parë, pritet një lidhje negative midis këtyre dy variablave, pasi bankat që sigurojnë të ardhura të larta nga komisionet do të jenë të prirura të ulin normat e interesit dhe si pasojë, edhe të ardhurat nga interesat dhe marzhin neto. Është menduar që ky variabël të përfshihet me kohëvonesë në ekuacion, pasi reagimi ndaj ndryshimit të të ardhurave nga komisionet, pritet të funksionojë pas njëfarë kohe tek të ardhurat neto nga interesat.

G) STRUKTURA E TREGUT

Në studimin në fjalë, ky tregues matet nga indeksi i përqendrimit në terma të kredive për çdo tremujor. Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) matet si shuma e katrorëve të pjesës së tregut të kredisë të çdo banke në treg. Një nivel më i lartë përqendrimi do të thotë më tepër fuqi nga ana e bankave, çka mund të sjellë në marzhe më të larta interesi. Literatura sugjeron dy hipoteza të kundërta në lidhje me ndikimin e përqendrimit në sjelljen e bankave ndaj çmimit. Hipoteza e parë është ajo Strukturë-Performancë (SPH), e cila argumenton se një sistem bankar më i përqendruar do të sillt në mënyrë oligopolistike dhe një përqendrim më i lartë do të sjellë vendosjen e marzheve më të larta nga ana e bankave. Hipoteza e dytë është ajo e Strukturës Eficiente (ESH) që pohon se përqendrimi prodhon rritje efieciencie (në terma të reduktimit të kostove) duke shkaktuar rënie të marzheve. Një tjetër arsye mund të jetë se bankat e mëdha kanë një strukturë të ndryshme të aktiveve që sjellin të

ardhura apo pasiveve që paguajnë interes, nga ajo e bankave më të vogla, çka mund të ndikojë interesat e marrë apo të paguar e detyrimisht edhe nivelin e marzhit të interesave.

H) RREZIKU I TREGUT

Një mënyrë e mirë për të matur rrezikun e tregut që bankat ndeshin gjatë operimit në të, është llogaritja e luhatshmërisë së normave të interesit. Në rastin tonë është llogaritur devijimi standard për normën e bonove të thesarit tremujore, për euriborin dhe liborin tremujor¹⁴. Dy variablat e fundit janë përfshirë në studim për faktin se pjesa më e madhe e kredive në sistemin bankar shqiptar janë në valutë¹⁵. Për qëllime të studimit, do të përfshihen në model të tre variablat në mënyrë të veçantë, për të parë edhe se cila prej normave të interesit ndikon më shumë marzhin neto të interesave.

4.2 TË DHËNAT DHE METODA E VLERËSIMIT

Në këtë studim është përdorur informacion i marrë kryesisht nga Banka e Shqipërisë por edhe institucione të tjera ndërkombëtare. Të dhënat janë tremujore dhe për banka të veçanta përgjatë periudhës mars 2002-dhjetor 2007, me qëllim identifikimin e efekteve të bankave individuale. Brock dhe Rojas-Suárez (2000) kanë dalë në konkluzionin se “mund të jetë çorientuese nëse fokusohemi në të dhëna të agreguara, për të kuptuar sjelljen e spread-eve”. Nëse do të përdoreshin të dhëna të agreguara për sistemin, jo vetëm që do të humbin karakteristikat e bankave individuale, por njëkohësisht edhe do të humbim shumë të dhëna (për shkak të serive të shkurtra kohore). Për rastin e bankave të sistemit bankar shqiptar, vlerësimi i ekuacionit do të bëhet duke përdorur metodën e katrorëve më të vegjël (OLS) në Panel Data¹⁶ me metodën e efekteve fikse, duke bërë të mundur kështu identifikimin e ndikimeve që mund të kenë karakteristikat specifike të çdo banke.

Numri total i observimeve të përdorura në studim është 273¹⁷ dhe të dhënat janë të pabalancuara. Duke ndjekur edhe modelin e studimit të Maudos e Fernández de Guevara (2004), janë përdorur filtrime sipas dy kritereve: së pari, për bankat e reja që janë krijuar

gjatë periudhës së marrë në shqyrtim, janë hequr nga studimi të dhënat e vitit të parë të veprimtarisë, për të shmangur efektin e ndonjë vlere jonormale në të dhënat. Së dyti, edhe për bankat që kanë pësuar ndryshime strukturore gjatë periudhës së marrë në studim, janë eliminuar të dhënat për disa tremujorë.

4.3 REZULTATET

Ekuacioni që do të vlerësohet mund të paraqitet në mënyrë të përmblodhur si më poshtë:

$$NIM_{it} = \alpha_i + \beta_1 \cdot OE_{it} + \beta_2 \cdot RAV_{it} + \beta_3 \cdot CR_{it-4} + \beta_4 \cdot MQ_{it} + \beta_5 \cdot RES_{it-2} + \beta_6 \cdot COM_{it-1} + \beta_7 \cdot HHI_{it} + \beta_8 \cdot MR_{it} + \epsilon_{it} \quad (3)$$

ku:

$i = 1, 2, \dots, N$ është banka e i -të; $t = 4, 5, \dots, T$ i përket tremujorit përkatës të marrë në shqyrtim

$\alpha_i, \beta_1, \beta_2, \beta_3, \beta_4, \beta_5, \beta_6, \beta_7, \beta_8$ është një vektor parametrash dhe α_i përfaqëson Efektet Fikse

NIM Variabli i varur (marzhi neto i interesave) i përlllogaritur respektivisht, $NIM_1 =$ Të ardhura neto nga interesat / Totalin e aktiveve dhe $NIM_2 =$ Të ardhura neto nga interesat / Totalin e aktiveve që sjellin të ardhura;

OE	Shpenzimet e veprimtarisë të llogaritura në raport ndaj aktiveve totale;
RAV	Qëndrimi ndaj rrezikut i matur si raport i kapitalit aksioner me totalin e aktiveve;
CR	Rreziku i kredisë i matur nga raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredive;
MQ	Cilësia e administrimit e matur si raport i shpenzimeve të veprimtarisë me të ardhurat bruto të veprimtarisë;

<i>RES</i>	Kosto oportune e rezervave (Rezerva në bankën qendrore / Totalin e aktiveve);
<i>COM</i>	Të ardhura nga veprimtari të tjera e matur si Të ardhura neto nga komisionet / (Të ardhura neto nga interesat + Të ardhura neto nga veprimtari të tjera);
<i>HHI</i>	Indeksi i përqendrimit Herfindahl-Hirschman në terma të kredive;
<i>MR</i>	Rreziku i tregut i matur në tre forma: devijimi standard i normave të interesit tremujore përkatësisht për bonot e thesarit, euribor dhe libor.

Në tabelën nr.1 jepen rezultatet e vlerësimit të tre ekuacioneve që analizojnë lidhjen e variablit të varur NIM_2 me gjithë variablat e pavarur. Variabli i fundit (rreziku i tregut) është shprehur në të tre format e tij, të matura përkatësisht nga devijimi standard i normave të interesit të bonove të thesarit (ekuacioni 4), euribor (ekuacioni 5) dhe libor (ekuacioni 6). Kjo është arsyeja pse janë paraqitur nga tre ekuacione për secilën formë të matjes së variablit të varur, duke vlerësuar në total gjashtë ekuacione.

Meqenëse NIM_2 është për nga mënyra e llogaritjes një tregues më i mirë se sa NIM_1 (pasi është një tregues më i përafërt i matjes së nivelit të eficiencës dhe më i përdorshëm për rastin e Shqipërisë), është menduar që në këtë tabelë të paraqiten rezultatet për treguesin e parë¹⁸. Nga krahasimi i tabelave nr. 1 dhe 3, shihet se rezultatet e marra janë të ngjashme për të dyja format e matjes së NIM , lidhur kjo edhe me faktin se këta dy matës së eficiencës nuk kanë shumë ndryshim në vlerë (shiko grafikun nr.1) . Edhe nëse do të krahasonim midis tyre rezultatet e marra për tre ekuacionet e vlerësuar të të njëjtit variabël të varur, vërehet se janë të përafërta dhe ndryshojnë vetëm për variablin e fundit (rrezikun e tregut) meqenëse ai është matur në forma të ndryshme për secilin prej ekuacioneve (ndërkohë që shtatë variablat e tjerë janë matur në të njëjtën formë në secilin prej tre ekuacioneve).

Treguesi R^2 i axhustuar është në nivele të kënaqshme, çka dëshmon se afërsisht 70 për qind e luhatjeve në marzhin neto të interesave, shpjegohet nga luhatshmëria e variablave të pavarur, të përfshirë në ekuacion.

Tabelë 1. Rezultatet ekonometrike të marra për variablin NIM₂.

Variablat e pavarur	Variabli i varur (NIM ₂)					
	Ekuacioni 4		Ekuacioni 5		Ekuacioni 6	
	Koeficienti	t-statistic	Koeficienti	t-statistic	Koeficienti	t-statistic
C	0.0132	7.8390	0.0124	7.5501	0.0123	7.1842
OE	0.0897	2.6988	0.1021	3.1458	0.0928	2.7837
RAV	-0.0111	-2.7569	-0.0095	-2.4379	-0.0099	-2.4671
CR(-4)	-0.0107	-2.2700	-0.0111	-2.4304	-0.0122	-2.5698
MQ	-0.0010	-5.0650	-0.0011	-5.8513	-0.0011	-5.5008
RES(-2)	0.0366	2.0588	0.0376	2.1742	0.0368	2.0688
COM(-1)	-0.0066	-3.8940	-0.0066	-3.9878	-0.0062	-3.6687
HHI	-0.0176	-2.1262	-0.0158	-2.0569	-0.0100	-1.2602
MR	0.1448	2.0981	0.9156	4.3777	0.1078	1.9221
R^2 i axhustuar	0.6865		0.7038		0.6856	
F-statistic	26.8978		29.0955		26.7924	
Prob(F-statistic)	0.0000		0.0000		0.0000	

Koeficienti para variablit të shpenzimeve të veprimtarisë paraqitet (ashtu siç pritej) me shenjë pozitive dhe statistikisht i rëndësishëm. Kjo do të thotë se marzhi neto i interesave rritet sa herë niveli i shpenzimeve të veprimtarisë rritet, për të mbuluar shpenzimet e shtuara. Ky rezultat është në përputhje edhe me konstatimet e marra nga analiza e zbërthimit kontabël të marzhit të interesave. Në rastin e bankave të sistemit bankar shqiptar, raporti i shpenzimeve të veprimtarisë me totalin e aktiveve ka një koeficient të vlerësuar prej 0.1021 (për ekuacionin 5) për regresionin e marzhit të interesave, çka tregon se rreth 10 për qind e shpenzimeve të veprimtarisë kalohet te kredimarrësit dhe depozituesit (në formën e normave të interesit më të larta për kreditë apo më të ulëta për depozitat).

Ndërsa pritej një lidhje pozitive midis marzhit neto të interesave dhe nivelit të kapitalizimit të bankave, për sistemin bankar shqiptar, kjo lidhje del negative. Shpjegimi i këtij fenomeni lidhet me

faktin se bankat me nivel më të lartë kapitali (që konsiderohen si rrezikundërshtuese) janë më të kujdesshme në drejtim të kreditimit, pasi më shumë kapital aksioner vendoset në rrezik. Bankat e mirëkapitalizuara që ndjekin një politikë konservatore, zgjedhin të japin kredi me më pak rrezik dhe me norma më të ulëta interesi. Në një rezultat të tillë kanë arritur edhe Brock dhe Rojas-Suárez (2000), duke argumentuar se për vendet me sisteme bankare ende jo shumë të konsoliduar, një sjellje e tillë mund të jetë normale.

Shenja e koeficientit para variablit që përfaqëson rrezikun e kredisë, rezulton negative dhe statistikisht e rëndësishme. Në fakt, nisur nga rezultatet empirike të autorëve të tjerë dhe nga zbërthimi kontabël i marzhit të interesave për sistemin tonë bankar, pritej një lidhje pozitive. Në disa studime të realizuara për disa vende të Amerikës Latine është konkluduar se shenja e koeficientit para variablit të kredive me probleme është negative, pra marzhi reagon negativisht ndaj një rritjeje të nivelit të kredive me probleme. Në rastin e Shqipërisë, marzhi reagon negativisht ndaj rritjes së nivelit të kredive me probleme, pas katër periudhash¹⁹. Rezultatet tregojnë se bankat shqiptare kanë synuar të rritin pjesën e tregut të kredive gjatë periudhës së marrë në shqyrtim, duke bërë që niveli i kredive me probleme të ndikojë negativisht në marzhet e caktuara.

Lidhja e marzhit të interesave me cilësinë e administrimit në rastin e bankave që operojnë në Shqipëri, rezultoi negative dhe e rëndësishme nga ana statistikore, ashtu siç pritej në përputhje edhe me rezultatet e marra nga studime të ngjashme. Nëse niveli i shpenzimeve të veprimtarisë që duhen për të gjeneruar një njësi të ardhur rritet, atëherë do të thotë se cilësia e administrimit bie dhe marzhet e siguruar do të bien, gjithashtu.

Marzhi neto i interesave lidhet pozitivisht me nivelin e rezervave të vendosura në Bankën e Shqipërisë dhe kjo lidhje është e rëndësishme. Bankat priren të rritin marzhet e interesit për të kompensuar të ardhurat e munguara nga mbajtja e rezervës së detyruar (e remuneruar me norma të ulëta) dhe sipas rezultateve, ato reagojnë pas rreth 6 muajsh në ndryshimin e marzheve, ndaj ndryshimit të nivelit të rezervës.

Në rastin e sistemit bankar shqiptar, koeficienti para variablit të të ardhurave jo nga interesat rezulton me shenjë negative dhe i rëndësishëm për të gjitha ekuacionet. Kjo do të thotë se bankat shqiptare nëse sigurojnë të ardhura më të larta nga komisionet, pas një tremujori janë të prirura të ulin normat e interesit për kreditë pasi i konsiderojnë të dyja burimet e të ardhurave, si zëvendësuese të njëra-tjetrës.

Një tjetër variabël shpjegues i përdorur në model është Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) në terma të kredive, lidhja e të cilit me marzhin neto rezulton negativisht e rëndësishme. Teorikisht dhe nga shumica e rezultateve empirike të studimeve të ndryshme, pritej një lidhje pozitive e këtij variabli me marzhin e interesave. Megjithatë, rezultate të ngjashme me rastin e Shqipërisë janë evidentuar edhe në studimin e Brock dhe Franken (2003) për disa nga variablat që matin spreadin në rastin e Kilit. Mesa rezulton nga ekuacionet, për rastin e sistemit bankar shqiptar, vërtetohet hipoteza e dytë, ajo e Strukturës Eficiente. Kjo do të thotë se bankat që operojnë në Shqipëri e shfrytëzojnë përqendrimin më të lartë në kredidhënie për t'u specializuar në drejtim të shërbimeve që ofrojnë dhe në drejtim të uljes së marzheve.

Rreziku i tregut është matur në tre forma të ndryshme për sistemin bankar shqiptar, pasi ai ndikohet shumë nga prania e depozitave dhe kredive në valutë të huaj²⁰. Bankat e sistemit bankar shqiptar aplikojnë tashmë norma interesi të ndryshueshme për kreditë që japin, duke marrë si bazë pikërisht normat e interesit për bonot e thesarit, euribor-in dhe liborin dhe duke aplikuar një shtesë mbi to, në nivele që ndryshojnë nga banka në bankë. Nga ekuacioni i parë rezulton se marzhi neto i interesave lidhet pozitivisht dhe në mënyrë të rëndësishme me luhatjet në normën tremujore të bonove të thesarit. Një lidhje pothuajse e fortë dhe pozitive ekziston edhe me devijimin standard të normës së liborit. Por lidhja pozitive më e fortë konstatohet për rastin e luhatjeve në normën e euriborit, ku për çdo 10 pikë përqindje luhatshmëri në normën e kësaj të fundit, do të vihet re një ndryshim prej më shumë se 9 pikë përqindje në marzhin e interesave. Këto rezultate pritëshin, pasi pjesa më e madhe e kredive në valutë, jepet në monedhën euro.

5. PËRFUNDIME

Në këtë studim u analizuan të dhëna të bankave individuale që operojnë në sistemin bankar shqiptar, për periudhën 2002-2007. Pas një trajtimi teorik dhe kontabël të përcaktuesve të marzhit neto të interesave, analiza u përqendrua në vlerësimin ekonometrik të faktorëve që ndikojnë variablin e varur. Ky studim jo vetëm do t'i ofrojë një punim të ri literaturës së shkruar rreth faktorëve që përcaktojnë marzhin neto të interesave, por edhe do të japë kontributin e një punimi të parë për rastin e Shqipërisë.

Nga ekuacionet që u vlerësuan u morën rezultate që në disa raste pritshin dhe disa të tjera ishin të ndryshme nga parashikimet. Marzhi neto i interesave për bankat që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri, ka një varësi të lartë nga luhatjet në normat bazë të interesit për monedhat euro, lek dhe dollar. Sistemi bankar shqiptar është karakterizuar vitet e fundit nga një rritje e shpejtë e kreditimit dhe nga një masë e madhe e kredive në valutë të huaj (sidomos në euro), ndërsa nga ana tjetër e bilancit burimet e fondeve (depozitat) janë kryesisht në lekë.

Bankat shqiptare priren të rritin marzhet e ndërmjetësimit ndërsa përballen me shpenzime më të larta operative. Së fundmi, bankat kanë qenë shumë agresive në drejtim të zgjerimit me degë të reja në të gjithë territorin e vendit dhe kjo, ka rritur nivelin e shpenzimeve të veprimtarisë duke rezultuar në rritjen e marzhit të interesave.

Edhe pse norma e rezervës së detyruar ka mbetur e pandryshuar gjatë periudhës në fjalë, vetë rritja e shumës së depozitave (edhe si pasojë e ofertave promovionale të bankave, sidomos në vitet e fundit) ka rezultuar në rritje të nivelit të rezervave të vendosura pranë bankës qendrore. Të ardhurat e munguara nga investimi në aktivitete më fitimprurëse i këtyre rezervave, i kanë detyruar bankat të kalojnë një pjesë të këtyre kostove te klientët e tyre.

Megjithëse zënë ende një peshë të ulët të të ardhurave totale, të ardhurat që bankat sigurojnë nga komisionet ndikojnë negativisht në marzhin e interesave. Bankat shqiptare ulin të ardhurat neto nga interesat sa herë që sigurojnë të ardhura më të larta nga

komisionet, pasi i konsiderojnë si zëvendësuese të njëra-tjetrës këto dy lloje të ardhurash.

Në rastin e Shqipërisë marzhi reagon negativisht ndaj rritjes së nivelit të kredive me probleme (pas katër periudhash). Mesa kuptohet, bankat shqiptare gjatë periudhës së marrë në shqyrtim i kanë kushtuar më shumë rëndësi rritjes së pjesës së tregut të kredive, gjë që është shprehur edhe në ofertat agresive promovionale të kohëve të fundit. Gjatë kësaj periudhe bankat kanë shtuar larmishmërinë e produkteve të kredisë që ofrojnë, por gjithashtu kanë shkurtuar edhe kohën e procesimit të kredive, pasojë kjo e konkurrencës gjithmonë në rritje në tregun e këtyre të fundit. Në këto kushte, kur konkurrenca bëhet gjithnjë e më e fortë dhe kur niveli i kredive me probleme ka qenë i ulët (pavarësisht se ky tregues ka ardhur në rritje), bankat janë ndier më të sigurta në caktimin e marzheve duke mos shkaktuar rritjen e tyre si pasojë e rrezikut të kredisë.

Megjithatë, bankat shqiptare tregohen konservatore kur bëhet fjalë për mbrojtjen e kapitalit të investuar nga aksionerët. Pavarësisht se kanë shfaqur agresivitet në zgjerimin e pjesës së tregut, ato përsëri kanë treguar kujdes për cilësinë e kredive të dhëna. Sa më shumë e kanë shtuar kapitalin (pasojë e kërkesave rregullative apo e zgjerimit të aktiviteteve që ofrojnë sipas niveleve të licencës), aq më të kujdesshme kanë qenë në përzgjedhjen e klientëve të tyre të kredisë, çka provohet edhe nga cilësia e mirë e portofolit të kredive për periudhën në fjalë.

Rezultatete marr nga kystudim, mund t'i shërbejnë politikëbërësve për orientimin drejt çështjeve që kanë më shumë lidhje me faktorët përcaktues të marzhit neto të interesave. Një vëmendje më e madhe mund t'i kushtohet luhatshmërisë së normave të interesit, nivelit të rezervës së detyruar, nivelit të kapitalizimit të bankave etj.. Ky studim synoi të identifikojë faktorët që ndikojnë më shumë marzhin neto të interesave për rastin e sistemit bankar shqiptar. Megjithatë, kjo punë e nisur mund të vazhdohet në të ardhmen me zgjerimin në drejtime të ndryshme për shembull, duke përfshirë në studim periudha më të gjata kohore. Me zgjatjen e serisë së të dhënave, mund të mundësohet edhe përfshirja e variablave të tjerë sidomos të natyrës makroekonomike.

LITERATURA:

- Afanasieff, Tarsila S., Priscilla M. Villa Lhacer and Márcio I. Nakane. 2002. "The Determinants of Bank Interest Rate Spreads in Brazil", Central Bank of Brazil Working Papers, 46, 2002.
- Angbazo, L. 1997. "Commercial Bank Net Interest Margins, Default Risk, Interest Rate Risk and Off-Balance Sheet Banking". *Journal of Banking and Finance*, 21, 55-87.
- Bawumia, Mahamudu, Franklin Belye and Martin E. Ofori. 2005. "The Determination of Bank Interest Spreads in Ghana: An Empirical Analysis of Panel Data", Bank of Ghana Working Paper 05/09
- Bernanke, Ben. 1983. "Nonmonetary effects of the financial crisis in the propagation of the Great Depression", *American Economic Review*, 73, 257-76.
- Berger, A. 1995. "The relationship between capital and earnings in banking". *Journal of Money, Credit and Banking*. Vol.27.
- Brock, Philip and Liliana Rojas-Suárez. 2000. "Interest rate spreads in Latin America: Facts, Theories and Policy Recommendations". Inter-American Development Bank, 2000. (Why So High? Understanding Interest Rate Spreads in Latin America).
- Brock, Philip and Helmut Franken. 2002. "Bank Interest margins Meet Interest Rate Spreads: How Good is Balance Sheet Data for Analyzing the Cost of Financial Intermediation?" Mimeo Central Bank of Chile.
- Brock, Philip and Helmut Franken. 2003. "Measuring the Determinants of Average and Marginal Bank Interest Rate Spreads in Chile, 1994-2001". Mimeo Central Bank of Chile.
- Claessens. Stijn, Asli Demirgüç-Kunt and Harry Huizinga. 1997. "How Does Foreign Entry Affect the Domestic Banking Market?". World Bank, Policy Research Department.
- Claeys, Sophie and Rudi Vander Vennet. 2004. "Determinants of Bank Interest Margins in Central and Eastern Europe: A Comparison with the West". Ghent University Working Papers, 316.


- Corvoisier, S. and R. Gropp. 2002. "Bank concentration and retail interest rates". *Journal of Banking and Finance* 26.
- Demirgüç-Kunt, Asli and Harry Huizinga. 1998. "Determinants of Commercial Bank Interest Margins and Profitability: Some International Evidence", *The World Bank Policy Research Working Paper*, 1900.
- Demirgüç-Kunt, Asli and Harry Huizinga. 1999. "Determinants of Commercial Bank Interest Margins and Profitability: Some International Evidence", *The World Bank Economic Review*, Vol.13, No.2, 379-408
- Estrada, Dairo, Esteban Gómez and Inés Orozco. 2006. "Determinants of Interest Margins in Colombia". *Borradores de Economía*. No. 393
- Gelos, R. Gaston. 2006. "Banking spreads in Latin America", *IMF Working Paper*, 06/44.
- Hanson, James A. and Roberto de Rezende Rocha. 1986. "High Interest Rates, Spreads and the Cost of Intermediation: Two Studies". *Industry and Finance*. Series 18.
- Ho, Thomas S. Y and Anthony Saunders. 1981. "The determinants of bank interest margins: Theory and empirical evidence". *Journal of Financial and Quantitative Analysis*, Vol.XVI, Nr.4, 1981.
- Khawaja, Idrees and Musleh-ud Din. 2007. "Determinants of Interest Spreads in Pakistan", *Pakistan Institute of Development Economic Working Papers*, 22, 2007.
- Lerner E.M. 1981. "Discussion the determinants of bank interest margins: theory and empirical evidence". *Journal of Financial and Quantitative Analysis*, Vol.XVI, Nr.4.
- Levine, Ross. 1997. "Financial Development and Economic Growth". *Journal of Economic Literature*, 35 (2).
- Liebeg, David and Markus S. Schwaiger. 2006. "Determinants of the Interest Rate Margins of Austrian Banks", *Oesterreichische Nationalbank Financial Stability Report*, 12(2006), 104-116.
- Maudos, Joaquín and Juan Fernández de Guevara. 2004. "Factors explaining the interest margin in the banking sectors of the European Union", *Journal of Banking and Finance* 28 (2004), 2259-2281.
- McShane, R.W and I.G Sharpe. 1985. "A time series/cross section analysis of the determinants of Australian trading

bank loan/deposit interest margins: 1962-1981". *Journal of Banking and Finance* 9. 115-136.

- Naceur, B. Samy. 2003. "The determinants of the Tunisian Banking Industry profitability: Panel evidence". Universite Libre de Tunis, Department of Finance Working Paper 2003.
- Robinson, W. John. 2002. "Commercial bank interest rate spreads in Jamaica-Measurement, trends and prospects". Discussion Paper 2002.
- Saunders. A. and L. Schumacher. 2000. "The determinants of bank interest rate margins: an international study". *Journal of International Money and Finance*, 19.


SHTOJCË

Grafik 3. Raporti Kredi/PBB për vitet 2002-2007.



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autores.

Grafik 4. Ecuria e të ardhurave jo nga interesat dhe e shpenzimeve të veprimtarisë në raport me totalin e aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autores.

Tabelë 2. Marzhi ex-ante për disa shtete (në %).

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Shqipëria	13.8	11.92	6.76	5.93	5.15	7.99	7.71	8.44
Bullgaria	8.24	8.19	6.41	5.61	5.82	5.58	5.72	6.32
Kroacia	8.33	6.32	10.95	10.05	9.88	9.48	8.21	6.99
Maqedonia	7.75	9.38	8.8	8.03	5.9	6.9	6.63	5.35
Bosnje Hercegovina	15.83	N/a	8.17	6.84	6.56	6.05	4.32	3.61

Burimi: International Financial Statistics, Qershor 2008.

Tabelë 3. Rezultatet ekonometrike të marra për variablin NIM_t .

Variablat e pavarur	Variabli i varur (NIM_t)					
	Ekuacioni 1		Ekuacioni 2		Ekuacioni 3	
	Koeficienti	t-statistic	Koeficienti	t-statistic	Koeficienti	t-statistic
C	0.0124	8.0805	0.0116	7.7678	0.0116	7.3812
OE	0.0631	2.0836	0.0745	2.5178	0.0659	2.1675
RAV	-0.0091	-2.4846	-0.0075	-2.1305	-0.0079	-2.1675
CR(-4)	-0.0092	-2.1397	-0.0096	-2.2988	-0.0107	-2.4495
MQ	-0.0010	-5.5187	-0.0011	-6.3512	-0.0010	-5.9798
RES(-2)	0.0335	2.0689	0.0343	2.1762	0.0336	2.0696
COM(-1)	-0.0068	-4.3944	-0.0067	-4.4835	-0.0064	-4.1426
HHI	-0.0191	-2.5417	-0.0171	-2.4368	-0.0117	-1.6099
MR	0.1459	2.3205	0.8492	4.4540	0.1011	1.9769
R ² i axhustuar		0.6713		0.6889		0.6693
Durbin-Watson		0.7551		0.7810		0.7851
F-statistic		25.1483		27.1924		24.9395
Prob(F-statistic)		0.0000		0.0000		0.0000

SHËNIME

*Të gjitha mendimet e shprehura në këtë studim janë të autores dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë. I jam mirënjohëse z. Altin Tanku, zj. Sofika Note, zj. Elona Dushku dhe zj. Elvida Orhan për sugjerimet e dhëna gjatë përgatitjes së këtij studimi.

¹ The Dealer Model.

² Për mënyrën e derivimit të ekuacionit, mund t'i referoheni Ho dhe Saunders (1981).

³ Liebeg dhe Schwaiger kanë gjetur një lidhje negative për rastin e sistemit bankar austriak.

⁴ Norma e aplikuar për sistemin bankar shqiptar është 10 për qind.

⁵ Shiko grafikun nr. 3 në shtojcë.

⁶ Numri i degëve të bankave në fund të vitit 2004 ishte 188, ndërsa arriti në 404 në vitin 2007.

⁷ Numri i punonjësve të punësuar në sistemin bankar shqiptar, arriti në 5.155 në fund të vitit 2007, nga 2.236 që ky numër ishte në vitin 2003.

⁸ Shiko grafikun 4 në shtojcë.

⁹ Më pas ky model është përdorur nga Saunders dhe Schumacher (2000), Estrada et al. (2006) etj..

¹⁰ Punime të ndryshme rreth marzhit të interesave kanë përdorur njërën apo tjetrën formë të llogaritjes, por fakti pse kam përfshirë edhe formën e dytë të llogaritjes në këtë studim, lidhet me përdorimin më të shpeshtë të kësaj forme në analizat e realizuara për sistemin bankar shqiptar

¹¹ Niveli minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat e sistemit bankar shqiptar është 12 për qind.

¹² Pasi është menduar se është më përfaqësues për matjen e kostove oportune në rastin e Shqipërisë, në dallim nga studimi origjinal ku ky variabël është matur nga raporti i rezervave likuide me totalin e aktiveve.

¹³ Norma e remunerimit për sistemin bankar shqiptar është sa 70 për qind e normës bazë të interesit të monedhës vendase, libor dhe euribor.

¹⁴ Për bonot e thesarit janë marrë normat javore të publikuara nga Banka e Shqipërisë për afat tremujor maturimi. Për euribor dhe libor tremujor janë marrë normat ditore të publikuara nga British Bankers Association.

¹⁵ Për muajin dhjetor 2007, kjo shifër arrin në 72.5 për qind.

¹⁶ Metoda e katrorëve më të vegjël është përdorur nga shumica e autorëve që kanë studiuar faktorët përcaktues të marzhit neto të interesave.

¹⁷ Numri i bankave të përfshira në studim varion nga 12 në vitin 2002, në 17 në vitin 2007.

¹⁸ Në tabelën nr. 3 jepen edhe tre ekuacionet e vlerësuara për NIM1 për secilën

formë të matjes së rrezikut të tregut.

¹⁹ Meqënëse të dhënat janë tremujore, do të thotë se reagimi i marzhit ndodh pas një viti.

²⁰ Kryesisht në euro dhe usd.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Irini Kalluci

- Përcaktuesit e Marzhit Neto të Interesave
në Sistemin Bankar Shqiptar - /
/ Kalluci Irini - Tiranë:
Banka e Shqipërisë, 2010

-40 f; 15.3 x 23 cm. (material diskutimi ..)

Bibliogr.

ISBN:

978-99956-42-27-3

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

*Në qoftë se dëshironi të keni kopje të
shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:*

*Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë Shqipëri,
Tel.: +355-(0)4-2222152;
Faks: +355-(0)4-2223558
ose duke dërguar një e-mail në adresën:*

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 500 kopje